



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:058421

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05874383

KPPP.nr.1349/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përbarimore të kreditorit Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë - Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë - KIESA, me seli Prishtinë, Lagja e Spitalit, rr. "Arbënor e Astrit Dehari" p.n., kundër debitorit NTSH "Elting-Elektronics", me NUI: 80241534, me seli në Prishtinë, rr. "Gazmend Zajmi" nr.9, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.156/2023 të datës 18.07.2023 të Përbaruesit Privat Emine Sherifi-Lubeniqi, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datë 28.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit NTSH "Elting-Elektronics", ANULOHET urdhri përbarimor P.nr.156/2023 i datës 18.07.2023 i lejuar nga Përbaruesi Privat Emine Sherifi-Lubeniqi dhe PËRFUNDOHET në tërësi përbarimi në këtë çështje përbarimore.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat Emine Sherifi-Lubeniqi, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë - Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë - KIESA, ka caktuar urdhrin P.nr.156/2023 të datës 18.07.2023, duke lejuar përbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës Nr. 4779 të datës 09.02.2022; Faturës Nr. 48119 të datës 08.03.2022; Faturës Nr. 2858 të datës 07.04.2022; Faturës Nr. 4897 të datës 10.05.2022; Faturës Nr. 4935 të datës 08.06.2022; Faturës Nr. 4975 të datës 18.07.2022; Faturës Nr. 5014 të datës 08.08.2022; Faturës Nr. 5053 të datës 07.09.2022; Faturës Nr. 5092 të datës 07.10.2022; Faturës Nr. 5131 të datës 07.09.2022 dhe Faturës Nr. 5170 të datës 12.12.2022, me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që në emër të përmbushjes së obligimeve nga dokumentet e

besueshme të lartcekura, brenda afatit prej 7 ditësh nga data e dorëzimit të urdhrit, t'ia paguaj kreditorit shumën prej 2,166.75 €, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbarimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të propozimit, ashtu që të gjitha këto detyrime duhet të realizohen përmes bllokimit të llogarive bankare të debitorit dhe bartjen e tyre në llogarinë bankare të veçantë të përmbaruesit dhe më pastaj nga kjo llogari të bëhet transferi në llogarinë e kreditorit, ose përmes zbatimit të përmbarimit duke bërë nga llogaritë e debitorit nga thesari dhe bartjen e tyre në llogarinë bankare të kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar vendimin e kreditorit, për faktin se që nga vdekja e pronarit i cili është edhe ideator i zhvillimit të biznesit në objektin e përmendur, debitori ka kërkuar që t'i lejohet ndërrimi i veprimtarisë në mënyrë që objekti të bëhet funksional, por që përgjigja nga pala kreditore ka qenë negative. Më tutje ka theksuar se vazhdimisht janë krijuar humbje nga pagesa e qirasë, pagesat e shpenzimeve komunale, andaj është bërë edhe dorëzimi i kërkesës tek zyrtarët përgjegjës të kreditorit të cilët kanë qenë të informuar se është e pamundur të bëhet përmbushja e obligimeve në mungesë të ofrimit të zgjidhjes edhe pas pesë viteve.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka deklaruar ndër të tjerash se ka pranuar kërkesën e debitorit dhe se e njëjta do të shqyrtohet në mbledhjen e bordit të palës kreditore. Në lidhje me pagesën e qirasë ka theksuar se në çdo fillim të muajit dorëzohen faturat e qirasë tek të gjitha bizneset që operojnë në Parkun e Biznesit në Glllogoc duke përfshirë edhe biznesin e debitorit lidhur me shfrytëzimin e parcelës. Gjykatës i ka propozuar që të vazhdohet me procedurë përmbarimore sipas kërkesës së kreditorit.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigja në prapësim, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të anulohet dhe procedura përmbarimore të përfundohet në tërësi për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Fatura Nr. 4779 e datës 09.02.2022; Fatura Nr. 48119 e datës 08.03.2022; Fatura Nr. 2858 e datës 07.04.2022; Fatura Nr. 4897 e datës

10.05.2022; Fatura Nr. 4935 e datës 08.06.2022; Fatura Nr. 4975 e datës 18.07.2022; Fatura Nr. 5014 e datës 08.08.2022; Fatura Nr. 5053 e datës 07.09.2022; Fatura Nr. 5092 e datës 07.10.2022; Fatura Nr. 5131 e datës 07.09.2022 dhe Fatura Nr. 5170 e datës 12.12.2022, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbnim, nuk i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbnim me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbnim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbnim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti - faturat në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbnim nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se këto fatura në rastin konkret janë lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk janë pranuar nga debitori, përkatësisht të njëjtat nuk përmbajnë nënshkrimin e pranuesit - debitorit dhe nuk ka dëshmi se janë pranuar nga debitori në çfarëdo forme. Andaj duke qenë së debitori nuk i ka pranuar në mënyrë të rregullt faturat, të njëjtat nuk mund të shërbejnë si dokument i besueshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumentet mbi të cilat mbështetet propozimi për përmbnim, e mbi bazën e të cilit Përmbnuesi Privat ka lejuar përmbnimin, nuk mund të shërbejnë si dokumente të besueshëm pasi që nuk kanë tipare të përmbnueshmërisë.

Gjykata në kuptim të nenit 71 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbnimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1349/23, datë 28.06.2024

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2024:058421
Datë: 28.06.2024
Numri i dokumentit: 05874383